



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 prill 2014

Numri i lëndës: 2013-22

Gani Gashi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 prill 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 2 shtator 2013.

II. FAKTET

2. Më 14 nëntor 2007, prokurori publik ndërkombëtar ka ngritur aktakuzë kundër parashtruesit të ankesës dhe e ka akuzuar atë për krime të

luftës kundër popullatës civile gjoja të kryera gjatë konfliktit në Kosovë në vitin 1998.

3. Më 3 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me një trup gjykues të përzier nga gjykatës të Kosovës dhe gjykatës ndërkombëtarë, ka dënuar ankuesin për vrasje, tentim vrasje dhe dy akuza për lëndime të rënda trupore. Gjykata e ka dënuar ankuesin shtatëmbëdhjetë vjet burgim.
4. Më 8 dhjetor 2008, Gjykata Supreme e Kosovës, me një trup gjykues të përzier të Kosovës dhe të gjykatësve ndërkombëtarë, pjesërisht ka vërtetuar ankesën e ankuesit dhe ka ulur dënimin e tij në pesëmbëdhjetë vjet burgim.
5. Më 6 gusht 2010, Gjykata Supreme ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

III. ANKESAT

6. Duke u thirrur në deklaratën universale të të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se e drejta e tij për gjykim të drejtë ishte shkelur dhe se ai ishte dënuar padrejtësisht.

IV. LIGJI

7. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike. Këto instrumente pasqyrojnë në një masë shumë të madhe të drejtat dhe vlerat themelore të njëjta me ato të nxjerra më herët në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut mbi të cilën ankuesi mbështetet.
8. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
9. Sipas rregullës 25, paragrafi 3 i rregullores së vet të punës, ankesat duhet të parashtrihen brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

10. Paneli vëren se shqetësimet e ankuesit në thelb kanë të bëjnë me rezultatin e procedurës penale kundër tij. Vendimi përfundimtar në ato procedura është dhënë më 6 gusht 2010, kur Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë kërkesën e ankuesit për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ai ka paraqitur ankesën e tij në Panel më 2 shtator 2013. Megjithatë, në pajtim me rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës, ankesa është dashur të parashtrohej brenda gjashtë muajve nga vendimi që kishte shkaktuar shkeljen e pretenduar, më së voni deri më 16 shkurt 2011. Prandaj, ankesa nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës së Panelit.
11. Në çfarëdo rasti, sipas rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë para gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka kompetencë të shqyrtoj qoftë aspektet administrative apo juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Ato janë në kompetencë vetëm të gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka gjetur se fakti që gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (ndër të tjera shih lëndët e PShDNj-së, *Lazić kundër EULEX-it*, nr. 2011-24 par. 20; *Jovanović*, nr. 2011-10, par. 33; dhe *Pajaziti*, nr. 2012-05, par 9).
12. Si rezultat, çështja e ngritur në këtë ankesë nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it KLosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri, konstaton se ankesa duhet të hedhet poshtë në pajtim me rregullën 29 (c) pasi ishte parashtuar jashtë afatit dhe; konstaton se në çfarëdo rasti nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën; gjen se ankesa bie jashtë juridiksionit të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese